
**TRADITA SHKRIMORE E SHQIPES I PARAPRIU PËRCAKTIMIT
TË ALFABETIT NË KONGRESIN E MANASTIRIT (1908)**
***THE LITERARY TRADITION OF THE ALBANIAN LANGUAGE
PRECEDED THE DETERMINATION OF THE ALPHABET AT THE
CONGRESS OF MANASTIR (1908)***

Prof. dr. MIMOZA KORE

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës

mimoza.kore@unitir.edu.al

Abstract

The Renaissance period, which marked the beginning of all progressive initiatives for Albanians, also addressed the challenge of unifying the alphabet of the Albanian language. The cultural awakening that characterized this era was accompanied by the proliferation of various writing systems, making the unification of a single alphabet particularly difficult. Further complicating this issue were the anti-Albanian efforts of the Ottoman authorities and neighboring countries, as well as the separatist and regionalist tendencies among Albanians themselves.

Language serves as one of the most defining elements of identity; in most cases, nations and states later organized themselves around the principle of a national language, written in a standardized alphabet. The efforts of the Renaissance leaders to create a unified alphabet were closely tied to the aspiration to open schools in the Albanian language and to resist foreign attempts at assimilation. While the Ottoman authorities were enrolling the youth of administrative centers into Turkish schools, the Catholic clergy in the North and the Greek Orthodox Church in the South were expanding Catholic schools and Greek-language institutions.

The centuries-long effort of Albanians to develop a written tradition in their own language persisted, with a focus on the Latin-based alphabet. Texts written in this alphabet, though historically distant from the Formula e Pagëzimit (Formula of Baptism), shared a consistent trajectory. The foundation stone for the alphabet's eventual standardization, culminating in the Congress of Manastir, was laid with the publication of the first Albanian book, Meshari (The Missal) by Gjon Buzuku.

Key words: Renaissance, alphabet, identity, standardization, Formula of Baptism, The Missal

Abstrakt

Periudha e Rilindjes, e cila shënoi fillimin e të gjitha nismave përparimtare për shqiptarët, trajtoi edhe sfidën e njësimi të alfabetit të gjuhës shqipe. Zgjimi kulturor që karakterizoi këtë epokë u shoqërua me përhapjen e sistemeve të ndryshme të shkrimit, duke e bërë veçanërisht të vështirë unifikimin e një alfabeti të vetëm. E ndërlikuan më tej këtë çështje përpjekjet antishqiptare të autoriteteve osmane dhe të vendeve fqinje, si dhe prirjet separatiste dhe rajonaliste mes vetë shqiptarëve.

Gjuha shërben si një nga elementet më përcaktuese të identitetit; në shumicën e rasteve, kombet dhe shtetet më vonë u organizuan rreth parimit të një gjuhe kombëtare, të shkruar me një alfabet të standardizuar. Përpjekjet e krerëve të Rilindjes për të krijuar një alfabet të njësuar ishin të lidhura ngushtë me aspiratën për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe për t'i rezistuar përpjekjeve të huaja për asimilim. Ndërkohë që autoritetet osmane po regjistronin të rinjtë e qendrave administrative në shkollat turke, kleri katolik në veri dhe kisha ortodokse greke në jug po zgjerorin shkollat katolike dhe institucionet në gjuhën greke.

Përpjekja shekullore e shqiptarëve për të zhvilluar një traditë të shkruar në gjuhën e tyre vazhdoi, me fokus në alfabetin latin. Tekstet e shkruara me këtë alfabet, edhe pse historikisht të largëta nga Formula e Pagëzimit (Formula e Pagëzimit), ndanin një trajektore të qëndrueshme. Guri i themelit për standardizimin përfundimtar të alfabetit, që kulmoi në Kongresin e Manastirit, u hodh me botimin e librit të parë shqip, Meshari nga Gjon Buzuku.

Fjalë kyçe: Rilindje, alfabet, identitet, standardizim, Formula e Pagëzimit, Meshari

Periudha e Rilindjes, nga ku fillojnë gjithë nismat punëmbara për shqiptarët, zgjidhi edhe problemin e njësimi të alfabetit të gjuhës shqipe. Zhvillimi kulturor që shënoi gjithë këtë lëvizje u shoqërua edhe me shtimin e alfabeve të ndryshme, çka e vështirësoi së tepërmi unifikimin e një alfabeti. Po t'i shtohen këtu edhe përpjekjet antishqiptare nga pushteti i osmaninjve dhe vendeve fqinje, si dhe qëndrimet separatiste e lokaliste të vetë shqiptarëve, zgjidhja e kësaj çështjeje u vështirësua edhe më shumë.

Po si shkruanin shqiptarët para kësaj periudhe? Duke hetuar morinë e alfabeve, ajo që bie menjëherë në sy është se shumica e atyre që shkruan para Kongresit të Manastirit, përdorën alfabetin latin. Një dëshmi e kësaj është një raport i vitit 1332,

shkruar nga arqipeshkvi i Tivarit, Guliem Adae, prelat francez, në të cilin shkruhet në latinisht: “Licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris” (Megjithëse shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga ajo e latinëve, megjithatë ata përdorin në të gjithë librat e tyre shkronjën latine).

Shqiptarët për një kohë të gjatë nën sundimin e perandorive të mëdha, duke e ndier veten si nënshtetas dhe qytetarë të këtyre perandorive dhe që ndanin të njëjtin besim me ta, nuk arritën të kultivonin sa duhet vetëdijen e të qenit kombësi e veçantë, për të krijuar kishën e tyre të pavarur dhe për të shkruar gjuhën e tyre. Ata, si të thuash, u mjaftuan që ruajtën gjuhën dhe zakonet e tyre që i dallonin nga të tjerët, por nuk u shtynë më tej për ta shkruar atë gjuhë. Kjo edhe për arsye se, siç është e kuptueshme, shkrimi i gjuhës është punë e një elite ose aristokracie kulturore vendase, një pjesë e së cilës nëpër qytete bregdetare ose që asimiluar, ose shërbehej me latinishten, greqishten, rrallë herë edhe me sllavishten, që ishin gjuhë zyrtare të kishës dhe të administratës, prandaj nuk ndiente nevojën për të shkruar gjuhën shqipe¹. Në këto gjuhë e mbanin korespondencën princat shqiptarë: Aranitasit, Topiajt, Muzakët, Kastriotët etj. Mbishkrimi i Kishës së Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, ndërtuar më 1381 prej Karl Topisë, gdhendur në këto tri gjuhë, është dëshmi e kësaj gjendjeje². Me pjesën tjetër të popullsisë vendase, që nuk dinte të shkruante e të lexonte, nuk mund të komunikohesh me shqipen e shkruar. Prandaj u desh të pritej shekulli XV, shekulli i luftërave të mëdha kundër pushtuesve osmanë, por edhe shekulli i përhapjes së ideve humaniste që të shkundte dhe të zgjonte aristokracinë dhe inteligjencën kishtarë shqiptarë nga letargjia shekullore dhe t’i ballafaqonte me veprime e ide të reja për të ndërmarrë nisma të mëdha. E kësaj periudhe (1462) është Formula e Pagëzimit, shkruar nga Pal Engjëlli. Formula e Pagëzimit e transliteruar besnikërisht nga origjinali paraqitet kështu:

Vnte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit.

Meqenëse shkrimi i kopjes është mjaft i qartë, leximi i fjalisë nuk ka pasur vështirësi nga botuesit, të cilët e kanë lexuar në të njëjtën mënyrë:

*Unte paghesont premenit Atit
et birit et spertit senit*

alternimi V ~ U është karakteristikë e grafisë latine: zakonisht në fillim të fjalës përdoret shkronja «v», ndërsa në mes në fjalës përdoret shkronja «u», pavarësisht nga vlera fonetike e secilit rast.

¹ Seit Mansaku, “Orientimi kulturor e fetar i shqiptarëve në mesjetë dhe fillimet e shkrimit të gjuhës shqipe”, botuar në *Meshari i Buzukut mriz i vlerave evropiane*, Zagreb 2005, f. 79-86.

² Shih: *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 1959, f. 156-157.

Alfabeti i Formulës është i tipit latin-italian, i cili është përdorur më vonë, me disa ndryshime e plotësime shenjash, edhe nga autorët e vjetër të Veriut. Në Formulë vihen re këto veçori në kodin alfabetik:

- përdorimi pa dallim i shkronjës lat. <e> për tingujt shqip /e/ dhe /ë/: *premenit*. Këta tinguj nuk janë dalluar as nga autorët e vjetër deri te Bogdani.
- përdorimi i <gh> për shqipen /g/ para zanores /e/, si në italishte, psh. *paghesont*.
- përdorimi i lat. <s> pa dallim për tingujt e shqipes /sh/ e /z/ si dhe për shqipen /s/, për të cilën në Formulë s'ka shembuj.

Megjithatë, siç vëren R. Memushaj,³ vetë Formula e Pagëzimit nuk mund të merret si datë e krijimit të alfabetit të shqipes. Shenjat grafike që janë përdorur për shkrimin e saj nuk mund të shërbejnë si dëshmi e ekzistencës së një alfabeti të gjuhës sonë.

Dokumenti i dytë i gjendur brenda komedisë “Epirota” një tekst-njëfjali: < *Drëburi te clofto gogle* > (Epirota: skena 11 rr. 803), autori i së cilës është i huaj ashtu siç dhe pritej, është pasqyruar grafikisht duke u mbështetur në kodin alfabetik dhe rregullat e ortografisë italiane të kohës.

Përpjekjet shekullore të shqiptarëve për të shkruar shqip vijuan përsëri me përdorimin e alfabetit me bazë atë latin. Shkrimet me këtë alfabet edhe pse të largëta në kohë me atë të Formulës së Pagëzimit patën të njëjtën prirje. Guri i themelit të ngrehinës së alfabetit që përfundoi me Kongresin e Manastirit u vendos me librin e parë shqip “Meshari” i Gjon Buzukut. Për E. Çabejn ky alfabet, në mos pikënisje, është pa dyshim një nga gurët e parë themelorë.⁴ Në vështrimin e mirëfilltë gjuhësor ka rëndësi të theksohet se Gj. Buzuku në pajtim me orientimin kulturor të shqiptarëve dhe me bindjet e formimin e tij përktheu shkrime të shenjta kryesisht nga latinishtja dhe zgjodhi alfabetin latin për të shkruar gjuhën shqipe, i cili u përgjigjej më mirë edhe veçorive të gjuhës shqipe. Ndryshe nga Formula e Pagëzimit, Buzuku për shqipen /g/ përdor shkronjën latine <g>, ndërsa kur kjo ndiqet nga /e/ ose /i/ përdor shenjën cirilike *cirilike @ (ѧ)*, të cilën e përdor zakonisht për tingujt e shqipes /gj/ e /q/.

Përdorimi i shkronjës <s> për tingullin e shqipes /sh/, që haset vetëm te Buzuku (autorët e tjerë përdorin grafinë italiane <sc>), është konsideruar nga studiuesit si Jokli e Çabej si ndikim i venecianishtes, meqenëse në këtë të folme tingulli /s/ i afrohet në shqiptim tingullit /sh/.

Grafema <s> për /z/ në *paghesont* është sigurisht ndikim i italishtes, dhe haset te Buzuku, i cili e përdor krahas shenjës më të zakonshme (ε) që e kanë të gjithë shkrimtarët e vjetër gegë. Ai përdori grafi e praktika shkrimi nga tradita latino-italiane. Disa grafi me origjinë sllave a greke që përdori ai për të shënuar disa tinguj

³ Rahmi Memushaj, “Veçori të fazës së parë të planifikimit gjuhësor të shqipes”, në *Der Kongress von Manastir-Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur*, Hamburg, 2009, f.48.

⁴ Eqrem Çabej, *Meshari* i Gjon Buzukut, I, Tiranë, 1968, f.45.

që i mungonin latinishtes, flasin dhe ato për lidhjet dhe ndikimet historike të shqipes me gjuhë të tjera.

Nga ana tjetër, Buzuku, duke përkthyer nga latinishtja dhe duke përdorur alfabetin latin në librin e parë në gjuhën shqipe i bëri një shërbim të madh historisë kulturore shqiptare. Ai e lidhi që në fillim fatin e shkrimit të gjuhës shqipe me fatin e gjuhëve të tjera perëndimore të Evropës. Ai krijoi kështu traditën e shkrimit të gjuhës sonë me alfabet latin që u ndoq dhe u konsolidua dhe nga autorë të tjerë pas tij, një traditë e qëndrueshme që mbizotëroi në të gjithë shekujt e mëvonshëm. Qysh te ky autor vihet re synimi i përputhjes së një foneme me një grafemë. Ai nuk u mjaftua me 24 shkronjat e latinishtes, po përdori dhe pesë diagrama për fonemat /gj, nj, sh, th, ll/ si dhe pesë monograme. Ky parim, i përputhjes së një foneme me një grafemë as u diskutua fare në Kongresin e Manastirit, ai ishte i gjithëpranuar dhe një çështje e tejkaluar, tashmë.

Përpjekjet që u bënë sidomos në shek. XVIII e XIX për ta shkruar shqipen edhe me alfabetin grek, me alfabetin turko-arab e me alfabete të veçanta nuk mund ta ndryshonin rrjedhën e kësaj tradite të themeluar nga Gjon Buzuku. Traditën e tij e ndoqën dhe autorët e tjerë si Budi e Bogdani. Ky i fundit është i pari që e dallon zanoren e mesme /ë/ me anë të shkronjës «è», e pas tij Gjon Kazazi (1743) që e riprodhoi atë me «æ» e ndonjëherë me «q». Nga autorët e vjetër, Budi, Bardhi e Bogdani përdorin pa dallim lat. «g»: «fetige», «lengim» etj.

Ndërsa te autorët e Veriut përdorimi i alfabetit latin ishte i kuptueshëm, për shkak të kontaktit dhe të edukimit të tyre në shkollat e kishës katolike romane, por vihet re se një prirje e tillë në fillim si diçka e pavetëdijshme, u bë prirje kombëtare. Edhe shumë të tjerë si Thimi Mitkoja edhe pse kishte pranuar pa rezervë alfabetin e Stambollit, më vonë anoi nga alfabeti latin⁵. Prirja e natyrshme e shqiptarëve gjën shprehje edhe në fjalët e ideologut të Rilindjes, Samiut i cili thoshte: Shqipëria është një copë vënt nga Evropa, dhe shqipëtarët janë një nga kombet e Evropësë, p'andaj dhe gjuha shqipe duhet të shkruhet me shkronjat e Evropësë do-me -thënë me shkronja latine.⁶

Në epokën e Rilindjes, shqiptarët, me sa duket, kërkonin të shkruanin shqipen me një alfabet jo të mbështetur në modelet ekzistuese dhe tipografikisht të përdorshme (latin, grek, cirilik, arab), por krejtësisht origjinal, por çka do të krijonte vështirësi teknike të pritshme dhe të pakapërcyeshme lehtë për kohën dhe për një lëvizje si Rilindja Kombëtare, që shqipen e shkruar kërkonte ta përdorte si mjetin e përhapjes së “dritës së diturisë. Kjo ndodhte, sepse gjatë kësaj epoke në vendet ballkanike po krijoheshin shtetet që ishin rezultat i proceseve identifikuese kombëtare, i veçimit sa të ishte e mundur dallues nga të tjerët. Duke qenë se gjuha është edhe mjeti më identifikues, kombet e shtetet më vonë, me ndonjë përjashtim, u organizuan sipas parimit të gjuhës kombëtare të shkruar me një alfabet origjinal. Përpjekjet e

⁵ Tomor Osmani, *Udhë e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999, f.275.

⁶ Sami Frashëri, *Vepra I*, Tiranë 1988, f.245.

rilindësve për një alfabet intensifikoheshin edhe më shumë sepse kjo ishte e lidhur edhe me dëshirën e madhe të çeljes së shkollave në gjuhën shqipe e nga ana tjetër kërkohej t'u bëhej ballë përpjekjeve të të huajve për asimilim. Ndërsa pushtuesi turk po e fuste rininë e qendrave administrative në shkollat turke, kleri katolik në Veri dhe kisha greke në Jug po shtonin shkollat katolike e ato ku mësohej greqishtja.

Janë domethënëse e tingëllojnë si kushtim ndaj rrezikut, fjalët e “babait të gjuhës shqipe” Kostandin Kristoforidhit në këtë kohë të errët: “...po ndë mos u shkroftë gjuha e shqipesë edhe sot mbë këtë ditë, nuk do të shkojnë shumë vjet, edhe nuk do të ketë më Shqipëri ndë faqe të dheut, as nuk do të shënonetë më emëri i Shqipërisë ndë hartat e botësë, as do të përmendetë bir shqiptëri a bijë shqiptëraje pas kësaj jete.”⁷ Edhe pse s'u mor me hartimin e një alfabeti, si poet atdhetar e si një nga zërat e fuqishëm të Rilindjes sonë, A. Z. Çajupi më 1898-ën botoi artikullin për “Abecedarë shqip” në të cilën shtroi idenë e alfabetit latin dhe ishte në kundërshtim të alfabetit grek e turk. “Zgjedhja e një alfabeti të përhershëm e të vetëm, që të përdoret nga të gjithë, është bërë sot më e domosdoshme se kurrë për ruajtjen e gjuhës dhe për formimin e saj si gjuhë letrare”⁸ Një tjetër rilindës që edhe pse jo gjuhëtar i përmasave të K. Kristoforidhit, por si njeri i letrave, politikan, historian e poet, Pashko Vasa del me një broshurë të titulluar “*Alfabeti latin, i përshtatur për gjuhën shqipe*” (1878). P. Vasa kërkonte të përkrahej alfabeti latin, sepse shqiptarët do të njiheshin me literaturën botërore, por dhe shkrimet shqipe do të ishin lehtësisht më të lexueshme nga të huajt⁹. Krahas kërkesave politike që kanë ndaj Perandorisë Osmane, përpjekjet e patriotëve nuk rreshtin për krijimin e alfabetit. Dikush kërkon një alfabet “sui generis” ose siç i ka quajtur J. Rrota “alfabeta gjithënduer fizjonomiet”.¹⁰

Në këto kushte u mbledh Kongresi i Manastirit, Komisioni i të cilit u ndodh përpara tri alternativave:

- të pranohej një nga alfabetet ekzistuese (të shoqërisë “Agimi”, të shoqërisë “Bashkimi” apo ai i Stambollit)

- të bëhej një përzierje alfabetesh

- të krijohej një alfabet i ri.

Komisioni vendosi për të tretën, por lidhur me tingujt e shqipes që i mungonin latinishtes, si: *dh, gj, ll, nj, sh, th, xh, zh*, u has në vështirësi dhe vendimi për një alfabet të ri u tërhoq. Komisioni, duke parë se ishte e pamundur të binin në ujdi për shkronjat e diskutueshme të një alfabeti të ri dhe “të shtyrë edhe nga disa shkaqe të jashtme”, siç pohohet në Rezolutën e Kongresit¹¹, vendosën të pranonin alfabetin e

⁷ Kostandin Kristoforidhi, Letër dërguar N. Naços.

⁸ Jup Kastrati, “Lufta për njësimin e alfabetit shqip në vitet 1878-1905, *Studime Filologjike*. 4, 1968, f. 109.

⁹ Tomor Osmani, vep. e cit. f. 246.

¹⁰ Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Shkodër, 2006, f. 116.

¹¹ Shaban Demiraj-Kristaq Prifti, “Kongresi i alfabetit të gjuhës shqipe dhe vendi i tij në

Stambollit e bashkë me të dhe një “*abc fjesht latine*”. Vendimi u shpall më 20 nëntor 1908 dhe ishte një fitore e madhe e lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që shërbeu edhe për forcimin politik midis shqiptarëve. Numri i alfabeve filloi të binte dhe brenda dy vjetëve u duk qartë se, megjithëse alfabeti i Stambollit i përmbahej më mirë parimit një fonemë - një grafemë shpallur dhe nga Sami Frashëri “për çdo zë të vetëm dhe të pandarë, një shkronjë”, hasi në vështirësi në shtypshkronjat e kohës, prandaj u mënjanua shpejt. Me alfabetin *fjesht latin* u realizuan botimet e mëpastajme duke treguar se deri më sot i ka plotësuar mirë kërkesat e gjuhës sonë të shkruar.

Kongresi i Elbasanit, i organizuar në shtator 1909, i dha fund një herë e përgjithmonë përdorimit të dy varianteve të alfabeve, duke pranuar vetëm alfabetin *fjesht latin* me dyshkronjëshat. Kjo bëri që alfabeti latin të përdorej edhe më shpejt se para afatit që zgjodhi Kongresi i Manastirit. Më në fund, alfabeti latin që përzgjodhi Buzuku, i përmirësuar e i plotësuar nga koha, në Kongresin e Manastirit (1908) u shpall si alfabet i përbashkët i gjuhës shqipe për të gjithë shqiptarët duke luajtur një rol të rëndësishëm për njësimin e gjuhës shqipe dhe bashkimin e shqiptarëve. Katër vite më vonë, më 1912-ën, me këtë alfabet u shkrua Deklarata e Pavarësisë.

Literatura

Çabej, E. *Meshari* i Gjon Buzukut, I, Tiranë, 1968, f.45.

Demiraj, Sh. -Prifti, K., “Kongresi i alfabetit të gjuhës shqipe dhe vendi i tij në kulturën shqiptare”, në *Der Kongress von Manastir-Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur*, Hamburg f.37.

Frashëri, S. *Vepra I*, Tiranë 1988, f.245.

Kastrati, J., “Lufta për njësimin e alfabetit shqip në vitet 1878-1905, SF. 4, 1968, f. 109.

Memushaj, R. “Veçori të fazës së parë të planifikimit gjuhësor të shqipes“, në *Der Kongress von Manastir-Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur*, Hamburg, 2009, f.48.

Osmani, T. *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999.

Rrota, J., *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, botimi I, Shkodër, 2006, f. 116.

Historia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1959, f. 156-157.

kulturën shqiptare” në *Der Kongress von Manastir-Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur*, Hamburg f.37.